



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DITARI MUJOR

MAJ 2024

Nga Tirana në Kukës, përfundon rehabilitimi në të tjera shkolla

Programi i rehabilitimit të shkollave dhe terreneve sportive vijon në të gjithë Shqipërinë. Falë mbështetjes së programit EU4Schools përfundoi rehabilitimi i shkollës 9-vjeçare "Ibrahim Basha" në Kamzë, gjimnazit "Myslym Keta" dhe "Xhezmi Delli". Falë investimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me pushtetin lokal kanë përfunduar ose janë drejt përfundimit shkollat "Muhamet Shehu", Patos, "Kostandin Kristoforidhi" në Elbasan, "Bajram Abdiu" në Bicaj të Kukësit, etj.



Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe 2024

Në një mbrëmje plot emocione dhe konkurrencë të fortë, u zhvillua Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe, me një finale që mbledhi së bashku nxënës, mësues, prindër, përfaqësues të institucioneve arsimore si dhe përfaqësues nga partnerët e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në finale u përballen dy shkollat finaliste, shkolla 9-vjeçare "Jeronim de Rada" nga Tirana dhe shkolla 9-vjeçare "Rilindja" nga Kavaja. Tema e konkursit për këtë vit ishte "Gjuha shqipe si identitet kombëtar, kulturor dhe mjet komunikimi në epokën e teknologjisë" dhe fituese u shpall shkolla 9-vjeçare "Rilindja" nga Kavaja.



Memorandumi i mirëkuptimit, Kuvendi miraton projektligjin për "Fulbright"

Kuvendi i Shqipërisë miratoi projektligjin "Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe SHBA për programin e shkëmbimit akademik "Fulbright". Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ofron një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor.

Nënshkruhet marrëveshja, UBT nis

reformimin në drejtimin e BOKU të Vienës

Me praninë e kryeministrit Edi Rama dhe ministres së Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkroi marrëveshjen me Universitetin BOKU të Vienës. Përgjatë një procesi 4-vjeçar, University of Natural Resources and Life Sciences do të jetë udhëzues i reformimit të UBT-së, që do të ofrojë programe studimi konkurruese në shkallë europiane, në shkencat bujqësore dhe ato të jetës (bujqësi, ushqim, mjedis dhe pyje); horizonte të reja në fushën e kërkimit shkencor dhe shndërrimin në një Qendër Ekselence Rajonale për transferimin e njohurive, teknologjisë dhe inovacionin në sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit.



Ministeriali i Arsimit të Lartë, 70 delegacione nga bota mbledhen në Tiranë



Për herë të parë Tirana u bë kryeqyteti i arsimit të lartë. Në datat 29-30 maj 2024 u mbajt Konferenca Ministeriale e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. Rreth 70 delegacione dhe 280 personalitete të larta shtetërore dhe ekspertë të arsimit ndanë eksperiencat dhe miratuan një dokument të përbashkët mbi afrimin ndaj vlerave themelore të arsimit, ndërkombëtarizimin, lirinë akademike, autonominë institucionale, dimensionin social dhe përgjegjësinë publike të arsimit të lartë. Shqipëria ndau të njëjtin qëndrim me EHEA mbi sigurimin e cilësisë në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG).

SHPALLEN FITUESIT E KAMPIONATIT TË EKIBEVE SPORTIVE NË SHKOLLA

Pas muajsh me emocione dhe përballje mes skuadrave u shpallën kampionët e Kampionatit të Ekipeve Sportive në Shkollë në volejboll dhe basketboll. Shkolla 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit", Kukës; "Halit Uruçi" Belsh dhe gjimnazet "28 Nëntori", Shkodër dhe "Havzi Nela", Kukës u shpallën fitues të kampionatit të voleybollit. Gjimnazi "Hasan Tahsini" i Sarandës u shpall kampion i dyfishtë në basketboll për djem dhe vajza i kampionatit për shkollat e mesme. Ndërsa ekipi i basketbollit të vajzave të shkollës "Hillary Clinton", Kamzë, dhe djemtë e ekipit të basketbollit të shkollës "Ali Laçej", Shkodër, fituan Kampionatin e Ekipeve Sportive për shkollat 9-vjeçare.



E ARDHMJA E ARSIMIT Mbledh Forumin Botëror të Edukimit

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, mori pjesë në Forumin Botëror të Edukimit që po zhvillohet në Londër, i cili mbledhi mbi 100 liderë, personalitete dhe kontributorë të arsimit. Fokusi i këtij Forumi ishte vizioni për të ardhmen e edukimit, ndarja e eksperiencave për përshtatjen e sistemeve arsimore në kohën e zhvillimeve të vrlshme të teknologjisë dhe inovacionit, inteligjencës artificiale, si dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë, më të fortë e më të qëndrueshëm.